

URDHËR
Nr. 349, datë 25.7.2022

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PRODUKTEVE DHE SUBSTANCAVE QË
PËRDOREN NË PRODHIMIN BIOLOGJIK¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 16 pika 2, të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e listës së produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin biologjik, bashkëlidhur këtij urdhri.
 2. Urdhri nr. 131, datë 28.3.2018, “Për miratimin e listës së produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin biologjik”, shfuqizohet.
 3. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Trupat e Kontrollit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

**LISTA E PRODUKTEVE DHE SUBSTANCAVE QË PËRDOREN NË PRODHIMIN
BIOLOGJIK**

Neni 1

Lëndët vepruese në përmbajtje të produkteve të mbrojtjes së bimëve

Vetëm lëndët vepruese të listuara në aneksin I të këtij urdhri, duhet të përmbahen në produktet e mbrojtjes së bimëve (PMB) që përdoren në prodhimin biologjik, me kusht që PMB-të:

- a) të jenë regjistruar sipas legjislacionit në fuqi për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve.
- b) të përdoren në përputhje me kushtet e përdorimit të përcaktuara në dokumentacionin e regjistrimit (certifikatë dhe etiketë);
- c) të përdoren në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve.

Neni 2

Produktet plehëruese, përmirësuesit e tokës dhe lëndët ushqyese

Vetëm produktet dhe substancat e përcaktuara në aneksin II të këtij urdhri, përdoren në prodhimin biologjik, si plehra, përmirësues të tokës dhe lëndë ushqyese për bimët, përmirësues dhe pasurues të shtrojës së kafshëve ose në kultivimin e algave ose mjedisit të mbarështimit të kafshëve të akuakulturës, me kusht që të jenë regjistruar sipas legjislacionit në fuqi për produktet plehëruese.

¹ Ky urdhër është përafruar pjesërisht me rregulloren zbatuese të Komisionit Evropian (BE) 2021/1165 të 15 korrikut 2021 që autorizon produktet dhe substancat eaktuara për t'u përdorur në prodhimin organik dhe krijimin e listës së tyre. Numri CELEX: 32021R1165, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L nr. 253, dt. 16.7.2021, faqe 13–48.

Neni 3

Lëndët jobiologjike për ushqim për kafshë, me origjinë bimore, shtazore, nga algat, majat ose me origjinë mikrobiale ose minerale

Vetëm produktet dhe substancat e listuara në pjesën A të aneksit III të këtij urdhri, përdoren në prodhimin biologjik si lëndë jo biologjike për ushqim për kafshë, me origjinë bimore, shtazore, alga, maja ose me origjinë mikrobiale ose minerale.

Neni 4

Aditivët e ushqimit për kafshë dhe ndihmësit në përpunim

Vetëm produktet dhe substancat e përcaktuara në pjesën B të aneksit III të këtij urdhri, përdoren në prodhimin biologjik si aditivë dhe ndihmës për përpunimin e ushqimit për kafshë, që përdoret në ushqyerjen e kafshëve.

Neni 5

Produkte për pastrim dhe dezinfektim

1. Produktet e listuara në pikën 1, të aneksit IV të këtij urdhri, përdoren për pastrimin dhe dezinfektimin e pellgjeve, kafazeve, rezervuarëve, ndërtesave ose instalimeve të përdorura në prodhimin biologjik shtazor.

2. Produktet e listuara në pikën 2, të aneksit IV të këtij urdhri, përdoren për pastrim dhe dezinfektim në prodhimin e specieve të akuakulturës dhe prodhimin e algave të detit.

ANEKS I

LËNDËT VEPRUESE NË PËRMBAJTJE TË PRODUKTEVE TË MBROJTJES SË BIMËVE, QË PËRDOREN NË PRODHIMIN BIOLOGJIK

Lëndët vepruese të listuara në këtë aneks, duhet të përmbahen në produktet e mbrojtjes së bimëve (PMB) të përdorura në prodhimin biologjik, me kusht që PMB-të:

a) të jenë të regjistruara paraprakisht sipas legjislacionit në fuqi për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;

b) të përdoren në përputhje me kushtet e përdorimit të përcaktuara në dokumentacionin e regjistrimit (certifikatë dhe etiketë);

c) të përdoren në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve.

Kushtet e veçanta dhe kufizimet për përdorim në prodhimin biologjik, përcaktohen në kolonën e fundit të tabelës.

Mbrojtësit, sinergjikët, bashkëformuluesit në përmbajtje të PMB-ve, dhe ndihmësit që përzihen me PMB-të, përdoren në prodhimin biologjik, me kusht që të jenë të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve. Substancat e përcaktuara në këtë aneks përdoren vetëm për kontrollin e dëmtuesve.

Këto substanca përdoren vetëm kur bimët nuk mbrohen mjaftueshëm nga dëmtuesit me masat e përcaktuara në legjislacionin për prodhimin biologjik bimor, në veçanti me përdorimin e agjentëve të kontrollit biologjik, si insektet e dobishme, marimangat dhe nematodat (lloj krimbi).

Lëndët vepruese ndahen në nënkategoritë e mëposhtme:

1. SUBSTANCAT BAZË

Substancat bazë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve, me origjinë nga produkte ushqimore bimore ose shtazore, përdoren për mbrojtjen e bimëve në prodhimin biologjik.

Substancat bazë që përdoren në prodhimin biologjik të listuara në tabelën e mëposhtme, janë shënuar me yll. Ato përdoren në përputhje me përdorimet, kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve, dhe kufizimet shtesë, nëse ka, në kolonën e fundit të tabelës më poshtë.

Substancat bazë nuk përdoren si herbicide.

Numri dhe pjesa e aneksit sipas kategorisë së lëndëve vepruese ²	CAS Numri unik identifikues	Emri i lëndës vepruese	Kushtet e përdorimit dhe kufizimet e veçanta
1C		Equisetum arvense L.*	
2C	9012-76-4	Chitosan hydrochloride*	Përfutur nga <i>Aspergillus</i> ose akuakulturë ose peshkim i qëndrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi për peshkimin.
3C	57-50-1	Saharoze (Sucrose*)	
4C	1305-62-0	Hidroksid calciumi (Calcium Hydroxide)	
5C	90132-02-8	Uthull (Vinegar*)	
6C	8002-43-5	Lecitine (Lecithins*)	
7C	-	<i>Salix</i> spp. Cortex*	
8C	57-48-7	Fruktozë (Fructose*)	
9C	144-55-8	Karbonat hidrogjen natriumi (Sodium hydrogen carbonate)	
10C	92129-90-3	Hirre (whey*)	
11C	7783-28-0	Fosfat di amoni (Diammonium phosphate)	Vetëm në kurthe
12C	8001-21-6	Vaj luledielli (Sunflower oil*)	
14C	84012-40-8 90131-83-2	<i>Urtica</i> spp. (<i>Urtica urens</i> extract)*	
15C	7722-84-1	Peroksid hidrogjeni (Hydrogen peroxide)	
16C	7647-14-5	Klorur natriumi (Sodium chloride)	
17C	8029-31-0	Birre (Beer*)	
18C	-	Pluhur farash të mustardës (Mustard seeds powder*)	
20C	8002-72-0	Vaj qepe (Onion oil*)	
21C	52-89-1	L-cysteine (E 920)	
22C	8049-98-7	Qumësht lope (Cow milk*)	
23C	-	<i>Allium cepa</i> * L. bulb extract	
		Substanca të tjera bazë me origjinë nga produkte ushqimore bimore ose shtazore.	

2. LËNDËT VEPRUESE ME RREZIK TË ULËT

Lëndët vepruese me rrezik të ulët, përveç mikroorganizmave, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve, të listuara në tabelën e mëposhtme, përdoren për mbrojtjen e bimëve në prodhimin biologjik, në përputhje me përdorimin, kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e bimëve, dhe kufizimet shtesë të përcaktuara në kolonën e fundit të tabelës.

Numri dhe pjesa e aneksit sipas kategorisë së lëndëve	CAS Numri unik	Emërtimi i lëndës vepruese	Kushtet e përdorimit dhe limitet e veçanta
---	-------------------	----------------------------	--

² Listimi sipas numrit dhe kategorisë: pjesët A dhe B, lëndët vepruese të miratuara sipas legjislacionit në fuqi (urdhrit nr. 72, datë 2.3.2017, "Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve, i ndryshuar), pjesa C substancat bazë, pjesa D substancat aktive me rrezik të ulët dhe pjesa E substanca për zëvendësim.

vepruese	identifikues		
2D	COS-OGA		
3D		Cerevisane dhe produkte të tjera bazuar në fragmentet e qelizave të mikroorganizmave (Cerevisane and other products based on fragments of cells of micro-organisms)	Jo me origjinë nga OMGJ-të.
5D	10045-86-6	Fosfat hekuri III-valent ortofosfat (Ferric phosphate (iron (III) orthophosphate)	
12D	9008-22-4	Laminarin	Algat e përfuara nga akuakultura biologjike ose të vjela/mbledhura në mënyrë të qëndrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbledhjen e qëndrueshme të algave të egra biologjike.

3. MIKROORGANIZMAT

Të gjithë mikroorganizmët e listuar në pjesët A, B dhe D të legjislacionit në fuqi për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve, përdoren në prodhimin biologjik, me kusht që të mos jenë me origjinë nga OMGJ-të dhe të përdoren në përputhje me përdorimet, kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve.

Mikroorganizmat përfshirë viruset janë agentë të kontrollit biologjik që konsiderohen si lëndë vepruese sipas legjislacionit në fuqi për PMB-të.

4. LËNDËT VEPRUESE TË TJERA, QË NUK PËRFSHIHEN NË KATEGORITË E MËSIPËRME

Produktet e mbrojtjes së bimëve, të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe me lëndë vepruese të listuara në tabelën më poshtë, përdoren në prodhimin biologjik në përputhje me përdorimet, kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve, dhe kufizimet shtesë, nëse ka, në kolonën e fundit të tabelës më poshtë.

Numri dhe pjesa e aneksit sipas kategorisë së lëndëve vepruese	CAS Numri unik identifikues	Emërtimi i lëndës vepruese	Kushtet e përdorimit dhe kufizimet e veçanta
139A	131929-60-7 131929-63-0	Spinosad	
225A	124-38-9	Dyoksid karboni (Carbon dioxide)	
227A	74-85-1	Etilen (Ethylene)	Vetëm në banane dhe patate, por mund të përdoret edhe për agrumet si pjesë e një strategjie për parandalimin e dëmtimit nga mizat e frutave.
230A	67701-09-1	Acidet yndyrore (Fatty acids)	Të gjitha përdorimet e lejuara sipas dokumentacionit të regjistrimit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi "Për miratimin e rregullave për regjistrimin, procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve", përjashtuar përdorimin si herbicid.
231A	8008-99-9	Ekstrakti i hudhrës (<i>Allium sativum</i>) Garlic extract (<i>Allium sativum</i>);	
234A	CAS No not allocated CIPAC No 901	Proteinat e hidrolizuara përjashtuar xhelatinën (Hydrolysed proteins excluding gelatine)	
244 A	298-14-6	Hidrogjen karbonat kaliumi (Potassium hydrogen carbonate)	
249A		Zmbrapsës nga aroma me origjinë	

	98999-15-6	shtazore ose bimore/dhjamë dele. (Repellents by smell of animal or plant origin/sheep fat)	
255A dhe të tjerë		Ferromone (Pheromones and other semiochemicals)	Përdoret vetëm në kurthe dhe si çorientues.
220A	1332-58-7	Silikat alumini (kaolin) (Aluminium silicate (kaolin))	
236A	236A	Kieselgur (tokë diatomike)	
247A	14808-60-7 7637-86-9	Rërë kuarci (Quartz sand)	
343A	11141-17-6 84696-25-3	Azadirachtin (ekstrakt Margosa)	Ekstraktuar nga farat e pemës Neem (Azadirachta indica);
240A	8000-29-1	Vaj citronela (Citronella oil)	Të gjitha përdorimet e lejuara sipas dokumentacionit të regjistrimit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, përjashtuar përdorimin si herbicid.
241A	84961-50-2	Vaj karafili (Clove oil)	Të gjitha përdorimet e lejuara sipas dokumentacionit të regjistrimit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, përjashtuar përdorimin si herbicid.
242A	8002-13-9	Vaj i farave të bërsisë së rrushit (Rape seed oil)	Të gjitha përdorimet e lejuara sipas dokumentacionit të regjistrimit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, përjashtuar përdorimin si herbicid.
243A	8008-79-5	Vaj mente (Spearment oil)	Të gjitha përdorimet e lejuara sipas dokumentacionit të regjistrimit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, përjashtuar përdorimin si herbicid.
56A	8028-48-6 5989-27-5	Vaj portokalli (Orange oil)	Të gjitha përdorimet e lejuara sipas dokumentacionit të regjistrimit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, përjashtuar përdorimin si herbicid.
228A	68647-73-4	Vaj i pemës së çajit (Tea tree oil)	Të gjitha përdorimet e lejuara sipas dokumentacionit të regjistrimit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, përjashtuar përdorimin si herbicid.
246A	8003-34-7	Pyrethrins ekstraktuar nga bimët (Pyrethrins extracted from plants)	
292A	7704-34-9	Sqfur (Sulphur)	
294A 295A	64742-46-7 72623-86-0 97862-82-3 8042-47-5	Vajra parafine (Paraffin oils)	
345A		Sulfuri i gelqeres (polisulfati i kalciumit)	

	1344-81-6	(Lime sulphur (calcium polysulphide));	
44B	9050-36-6	Maltodekstrin (Maltodextrin)	
45B	97-53-0	Eugenol	
46B	106-24-1	Geraniol	
47B	89-83-8	Timoli (Thymol)	
10E	20427-59-2	Hidroksid bakri (Copper hydroxide)	Siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi, urdhri nr. 72, datë 2.3.2017 “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, ku doza maksimale e përdorimit total është 28 kg bakër për hektar për një periudhë 7-vjeçare.
10E	20427-59-2	Oksikloridi i bakrit (Copper oxychloride)	
10E	1317-39-1	Oksid bakri (Copper oxide)	
10E	8011-63-0	Bordeaux mixture	
10E	12527-76-3	Sulfat bakri tre bazik (Tribasic copper sulphate)	
40A	52918-63-5	Deltamethrin	Vetëm në kurthe me tërheqës specifike kundër <i>Bactrocera oleae</i> dhe <i>Ceratitis capitata</i>
5E	91465-08-6	Lambda-cyhalothrin	Vetëm në kurthe me tërheqës specifike kundër <i>Bactrocera oleae</i> dhe <i>Ceratitis capitata</i> .

ANEKS II

PLEHRAT, PËRMIRËSUESIT E TOKËS DHE LËNDËT USHQYESE

Në prodhimin biologjik përdoren plehrat, përmirësuesit e tokës dhe lëndët ushqyese të listuara në këtë aneks, me kusht që të jenë në përputhje me:

- Legjislacionin në fuqi për produktet plehëruese.
- Në përputhje me legjislacionin në fuqi për prodhimin biologjik bimor, në veçanti rregullat për menaxhimin e tokës dhe plehërimin.

Përgatitjet e mikroorganizmave, gjithashtu, përdoren si përmirësues të përgjithshëm të tokës ose për përmirësimin e përmbajtjes së lëndëve ushqyese në tokë ose në bimë.

Kushtet kufizuese për përdorim në prodhimin biologjik përcaktohen në kolonën e fundit të tabelës.

Emri i produktit Produktet e përbëra ose produktet që përmbajnë vetëm substancat e listuara në aneks.	Përshkrimi, kushtet e përdorimit dhe kufizimet
Pleh i prodhuar në fermë (Farmyard manure)	Produkt që përmban përzierje të jashtëqitjeve të kafshëve dhe lëndë bimore (shtrojat e kafshëve dhe lëndë të para për ushqim për kafshë). Ndalohen produktet me prejardhje nga ferma industriale/intensive.
Pleh ferme i thatë dhe pleh i dehidratuar nga shpendët (Dried farmyard manure and dehydrated poultry manure);	Ndalohen produktet me prejardhje nga ferma industrial/ intensive.
Jashtëqitjet e kafshëve, të kompostuara, përfshirë plehun e shpendëve dhe plehrat e kompostuara të fermës (Composted animal excrements, including poultry manure and composted farmyard manure included);	Ndalohen produktet me prejardhje nga ferma industrial/ intensive.
Jashtëqitjet e lëngshme të kafshëve (Liquid animal excrements);	Përdoret pas fermentimit të kontrolluar dhe/ose tretjes/hollimit të mjaftueshëm. Ndalohen produktet me prejardhje nga ferma industriale/ intensive.
Përzierje të mbetjeve shtëpiake, të kompostuara ose të fermentuara (Composted or fermented mixture of household waste).	Produkt i përfutur nga mbetjet shtëpiake të ndara në burim, të cilat i janë nënshtruar kompostimit apo fermentimit anaerobik për prodhimin e biogazit. Përdoren vetëm mbetjet shtëpiake bimore dhe shtazore, kur prodhohen në një sistem grumbullimi të mbyllur dhe të kontrolluar. Përqendrimet maksimale të lëndës së thatë në mg/kg: kadmiumi 0.7; bakër 70; nikeli 25; plumb 45; zink 200; merkur 0.4; krom (total) 70; krom (IV) nuk dedektohet.
	Përdorimi i kufizuar në hortikulturë (kopshtari, lulëtari, fidanishte

Torfë (Peat)	pyjore dhe frutore).
Mbetjet e kulturave të kërpudhave (Mushroom culture wastes)	Përbërja fillestare e substratit të përmbajë vetëm produktet e përcaktuara në këtë aneks.
Mbetjet e krimbave (krimbat e kompostimit) dhe insekteve (mbeturina të imta pluhur ose dru i brishtë i shpuar i prodhuar nga aktiviteti i insekteve). (Dejecta of worms (vermicompost) and insect frass-substrate mixture).	Kur është e përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për nënproduktet nga kafshët.
Pleh i shpendëve të egër (Guano)	
Përzierje e kompostuar ose e fermentuar e lëndëve bimore (Composted or fermented mixture of vegetable matter).	Produkti i përfutur nga përzierja e mbetjeve bimore, të cilat i nënshtrohen kompostimit ose fermentimit anaerobik për prodhimin e biogazit.
Produkte që përfitohen nga nënproduktet e kafshëve që përdoren për prodhimin e biogazit, të përziera me lëndë të tjera me origjinë bimore ose shtazore të përcaktuara në këtë Aneks. (Biogas digestate containing animal by-products co-digested with material of plant or animal origin as listed in this Annex).	Nënproduktet e kafshëve (përfshirë nën-produktet e kafshëve të egra) të kategorisë 3 dhe aparatit tretës të kategorisë 2. Ndalohen produktet me prejardhje nga ferment industrial/ intensive. Nuk aplikohet në pjesët e ngrënshme të bimëve.
Produktet ose nënproduktet e kafshëve si më poshtë: Miell gjaku (Blood meal); Miell thundre (Hoof meal); Miell briri (Horn meal); Miell kockash ose miell i dextralatinuar kockash (Bone meal or degelatinised bone meal); Miell peshku (Fish meal); Miell mishi (Meat meal); Miell puplash, qimesh (Feather, hair and skin meal (chiquette); Lesh (wool); Gëzof (Fur); Qime (Hair); Produktet e qumështit (Dairy products); Proteina të hidrolizuara (Hydrolysed proteins);	1. Përqendrimi maksimal në mg/kg të lëndës së thatë të kromit (VI): nuk dedektohet (0). 2. nuk lejohet të aplikohet në pjesët e ngrënshme të bimëve.
Produktet dhe nënproduktet me origjinë bimore për pleh (Products and by-products of plant origin for fertilisers).	Shembuj: mbetjet e farave vajore të përpunuara, lëvozhgat e kakaos, gëzhutë malti.
Proteinat e hidrolizuara me origjinë bimore (Hydrolysed proteins of plant origin).	
Algat e detit dhe produktet e tyre (Algae and algae products).	Nëse përfitohen direkt nga: i) procese fizike përfshirë dehidratimin, ngrirjen dhe bluarjen; ii) ekstraktimi me ujë ose tretësirë ujore acide dhe/ose bazike; iii) fermentimi; Vetëm algat biologjike ose të mbledhura/vjela në mënyrë të qëndrueshme.
Tallash dhe ashkla druri (Sawdust and wood chips).	Dru i pa trajtuar kimikisht pas prerjes.
Lëvore druri e kompostuar (Composted bark);	Dru i pa trajtuar kimikisht pas prerjes..
Hi nga druri (wood ash);	Nga druri i pa trajtuar kimikisht pas prerjes.
Fosfate nga shkëmbinj të butë (Soft ground rock phosphate).	Përfutur nga bluarja e fosfateve minerale të buta dhe që përmban fosfat trikalciumi dhe karbonat kalciumi si përbërës kryesorë; përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (përqindje në peshë): 25% P ₂ O ₅ fosfor i shprehur si P ₂ O ₅ i tretshëm në acide minerale, të paktën 55% e përmbajtjes së P ₂ O ₅ të jetë i tretshëm në 2% acid formik madhësia e grimcave: - të paktën 90% e peshës arrin të kalojë nëpër një sitë me vrima 0,063 mm; - të paktën 99% e peshës arrin të kalojë nëpër një sitë me vrima 0,125 mm; Për kontaminantët, zbatohen limitet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për produktet plehëruese.
Fosfate alumin-kalciumit (Aluminium-calcium phosphate).	Produkt i përfutur në formë amorfe nga trajtimi termik dhe bluarja, që përmban fosfate alumini dhe kalciumi si përbërës thelbësorë. Përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (përqindja në peshë): 30% P ₂ O ₅ fosfor i shprehur si P ₂ O ₅ i tretshëm në acide minerale, të paktën

	75% e përmbajtjes së deklaruar të P_2O_5 është i tretshëm në citratin alkalik të amonit (Joulie); madhësia e grimcave: - të paktën 90% në peshë të kalojë nëpër një sitë me një rrjetë prej 0,160 mm; - të paktën 98% në peshë të kalojë nëpër një sitë me një rrjetë prej 0,630; Për kontaminantët, zbatohen limitet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për produktet plehëruese. Përdorimi i kufizuar në toka bazike ($pH > 7,5$).
Skorje bazike (Basic slag (Thomas phosphates or Thomas slag).	Produkt i përfutur nga hekur i shkrirë nga trajtimi i shkrirjeve të fosforit dhe që përmban silikofosfate kalciumi si përbërës thelbësorë, përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (përqindja në peshë): 12% P_2O_5 fosfor i shprehur si pentoksid fosfori i tretshëm në acide minerale, të paktën 75% e përmbajtjes së deklaruar të pentoksidit të fosforit të jetë i tretshëm në 2% acid citrik ose 10% P_2O_5 fosfor i shprehur si pentoksid fosfori i tretshëm në 2% acid citrik; madhësinë e grimcave: - të paktën 75% të kalojnë nëpër një sitë me një rrjetë prej 0,160 mm; - të paktën 96% të kalojë nëpër një sitë me rrjetë 0,630 mm; Për kontaminantët, zbatohen limitet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për produktet plehëruese.
Kripa të papërpunuara të kaliumit (Crude potassium salt).	Produkt i përfutur nga kripërat e papërpunuara të kaliumit përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (përqindja në peshë): 9% K_2O kaliumi i shprehur si K_2O i tretshëm në ujë 2% MgO; magnezi në formën e kripërave të tretshme në ujë, i shprehur si oksid magnezi. Për kontaminantët, zbatohen limitet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për produktet plehëruese.
Sulfati i kaliumit, që përmban kripë magnezi (Potassium sulphate, possibly containing magnesium salt).	Produkti i përfutur nga kripa e kaliumit të papërpunuar me procesin e ekstraktimit fizik, që përmban edhe kripëra të magnezit.
Kashta dhe ekstrakti i kashtës (Stillage and stillage extract).	Përrjashtuar kashtën e amonizuar
Karbonati i kalciumit p.sh., shkumës, argjilë, gurë gëlqeror, përmirësuesi Breton, shkumës fosfati (Calcium carbonate, for instance: chalk, marl, ground limestone, Breton ameliorant (maerl), phosphate chalk).	Vetëm me origjinë natyrore.
Mbetje të molusqeve (Mollusc waste)	Vetëm nga akuakultura ose peshkim i qëndrueshëm.
Levozhgët e vezëve (Egg shells)	Ndalohen ato me origjinë nga rritja në fabrika.
Karbonat magnezi dhe kalciumi (Magnesium and calcium carbonate).	Vetëm me prejardhje natyrore p.sh. shkumës magnezi, mineral magnezi, gur gëlqeror.
Sulfat magnezi (Magnesium sulphate (kieserite).	Vetëm me origjinë natyrore
Tretësirë e klorurit të kalciumit (Calcium chloride solution).	Vetëm për trajtimin me gjethe të pemëve të mollës, për të parandaluar mungesën e kalciumit.
Sulfat kalciumi, gips (Calcium sulphate,gypsum).	Produkt me origjinë natyrore që përmban sulfat kalciumi në shkallë të ndryshme hidratimi përmbajtja minimale e lëndëve ushqyese (përqindja në peshë): 25% CaO, 35% SO_3, kalcium dhe squfur i shprehur si total i bluarjes $CaO + SO_3$: - të paktën 80% të kalojë nëpër sitë me rrjetë 2 mm; - të paktën 99% të kalojë nëpër një sitë me rrjetë 10 mm; Për kontaminantët, zbatohen limitet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për produktet plehëruese.
Nënprodukte (gëlqere) industriale nga prodhimi i sheqerit (Industrial lime from sugar production).	Nënprodukt i prodhimit të sheqerit nga panxhari i sheqerit dhe kallam sheqeri.
Nënprodukt (gëlqere) industrial nga prodhimi i kripës me vakum (Industrial lime from vacuum salt production).	Nënprodukt nga prodhimi i kripës së prodhuar me vakum nga uji i kripur që buron nga malet.
Squfuri i thjeshtë (Elemental Sulphur).	Për kontaminantët, zbatohen limitet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për produktet plehëruese.
Plehrat inorganike mikroushqyese (Inorganic Micronutrient	Për kontaminantët, zbatohen limitet e përcaktuara në legjislacionin

Fertilisers).	në fuqi për produktet plehëruese. Produktet e përcaktuara në shtojcën 1, paragrafi E, të vendimit nr. 774, datë 7.11.2012 “Për rregullat, kërkesat e prodhimit, të etiketimit e të paketimit për vendosjen në treg e tolerancat dhe listën e tipave të plehrave me emërtimin “EC fertilizers”.
Klorur natriumi, kripa e gjelles (Sodium chloride).	
Pluhur guri dhe argjilë (Stone meal, clays and clay minerals).	
Leonardite (sedimente organike të pasura me acide Humike) Leonardite (Raw organic sediment rich in humic acids).	Vetëm nëse përftohet si nënprodukt nga minierat.
Acidi humik dhe fulvik (Humic and fulvic acids).	Vetëm nëse përftohet nga kripërat/tretësirat inorganike, duke përfshirë kripërat e amonit; ose të përfthuara nga pastrimi i ujit të pijshëm;
Xylite	vetëm nëse përftohen si nënprodukt i aktiviteteve minerare (p.sh. nënprodukt i minierave të qymyrit kafe).
Chitin (Polisakaride të përfthuara nga guackat e krustaceve); (Chitin (Polysaccharide obtained from the shell of crustaceans);	Vetëm nëse përftohet nga akuakulture biologjike dhe peshkim i qëndrueshëm.
Sedimente biologjike të pasura, nga burimet ujore të rrjedhshme të formuara nga largimi i oksigjenit; (Organic rich sediment from fresh water bodies formed under exclusion of oxygen (e.g. sapropel);	Vetëm sedimentet biologjike që janë nën-produkte të burimeve ujore të rrjedhshme të menaxhuara ose të përfthuara nga burime ujore të rrjedhshme të regjistruara/njohura. Përfitimi i tyre duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të shkaktojë ndikim minimal në sistemin ujor. Vetëm sedimentet e përfthuara nga burime të pakontaminuara nga pesticidet, ndotësit biologjike të qëndrueshëm dhe nënprodukte të naftës. Për kontaminantët, zbatohen limitet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për produktet plehëruese.
Biochar - produkt i pirolizës i përfthuar nga një shumëllojshmëri lëndë biologjike me origjinë bimore dhe aplikohet si përmirësues toke; (Biochar – pyrolysis product made from a wide variety of organic materials of plant origin and applied as a soil conditioner).	Vetëm nga lëndë bimore, që trajtohen pas korrjes vetëm me produkte të përfshira në aneksin I. Për kontaminantët, zbatohen limitet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për produktet plehëruese.

ANEKS III

PRODUKTE DHE SUBSTANCA QË PËRDOREN SI USHQIM PËR KAFSHË OSE NË PRODHIMIN E USHQIMIT PËR KAFSHË

PJESA A

Lëndët ose ushqimi për kafshë, jobiologjike, me origjinë bimore, alga, shtazore, maja, mikrobike ose minerale, siç përcaktohet në nenin 3, të këtij urdhri.

1. Lëndët për ushqim për kafshë, jo biologjike, me origjinë minerale

Numri në katalogun e ushqimit për kafshë	Emërtimi	Kushtet e veçanta dhe kufizimet
11.1.1	Karbonat kalciumi (Calcium carbonate).	
11.1.2	Guacka të detit, gelqerore (Calcareous marine shells)	
11.1.4	Maerl	
11.1.5	Lithotamn	
11.1.13	Glukonat kalciumi (Calcium gluconate).	
11.2.1	Oksid magnezi (Magnesium oxide).	
11.2.4	Sulfat magnezi anhidrik (Magnesium sulphate anhydrous).	
11.2.6	Klorur magnezi (Magnesium chloride)	
11.2.7	Karbonat magnezi (Magnesium carbonate).	
11.3.1	Fosfati i dikalciumit (Dicalcium phosphate).	
11.3.3	Fosfat monokalciumi (Monocalcium phosphate)	
11.3.5	Fosfati i magnezit të kalciumit CaMgO_4P^+ (Calcium-magnesium phosphate)	
11.3.8	Fosfat magnezi (Magnesium phosphate)	
11.3.10	Fosfat mononatriumi NaH_2PO_4	

	(Monosodium phosphate)	
11.3.16	Fosfat natrium kalciumi (Calcium sodium phosphate).	
11.3.17	Fosfati i monoamonit (Amonium dihidrogjen ortofosfat (Monoammonium phosphate (Ammonium dihydrogen orthophosphate)	Vetëm në akuakulturë
11.4.1	Klorur natriumi (Sodium chloride)	
11.4.2	Bikarbonat natriumi (Sodium bicarbonate)	
11.4.4	Karbonat natriumi (Sodium carbonate)	
11.4.6	Sulfat natriumi (Sodium sulphate)	
11.5.1	Klorur kaliumi (Potassium chloride)	

2. Substanca të tjera, si lëndë për ushqim për kafshë

Numri në katalog	Emërtimi	Kushtet e veçanta dhe kufizimet
10	Ushqim, vaj dhe lëndë të tjera për ushqim për kafshë me origjinë nga peshku ose kafshë të tjera ujore. (Meal, oil and other feed materials of fish or other aquatic animals origin).	- me kusht që të përftohen nga peshkimi i qëndrueshëm, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për peshkimin; - me kusht që të prodhohen ose përgatiten pa tretës kimikisht të sintetizuar; - përdoren vetëm për kafshët jobarngrenëse; - përdorimi i hidrolizatit të proteinave të peshkut përdoret vetëm për kafshët e reja jobarngrenëse.
10	Ushqim, vaj dhe lëndë të tjera për ushqim për kafshë me origjinë nga peshku, molusqet ose krustacet; (Meal, oil and other feed materials of fish, mollusc or crustacean origin).	- Për kafshët mishngrënëse të akuakulturës; - me kusht që të përftohen nga peshkimi i qëndrueshëm, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për peshkimin; - të përfutuara nga prerja e peshqve, krustaceve ose molusqeve të kapur për konsum njerëzor, ose të përfutuara nga peshk, krustace ose molusqe të plota, të kapura jo për konsum njerëzor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për akuakulturën biologjike.
10	Ushqim/miell peshku dhe vaj peshku (Fishmeal and fish oil).	Në fazën e rritjes, për peshqit në ujërat e brendshme, karkalecat të familjes Penaeidae dhe karkalecat e ujërave të ëmbla dhe peshqit tropikal të ujërave të ëmbla. - me kusht që të përftohen nga peshkimi i qëndrueshëm, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për peshkimin; - vetëm kur ushqimi natyror në pellgje dhe liqene nuk është në sasi të mjaftueshme, maksimumi 25% miell peshku dhe 10% vaj peshku në racionin e ushqimit të karkalecave të familjes Penaeidae penaeid dhe karkalecave të ujërave të ëmbla (<i>Macrobrachium spp.</i>) dhe maksimumi 10% miell peshku ose vaj peshku në racionin e ushqimit të mustakëve (peshk i madh) siamez (<i>Pangasius spp.</i>).
ex 12.1.5	Majat (Yeasts)	- Maja e përftuar nga <i>Saccharomyces cerevisiae</i> ose <i>Saccharomyces carlsbergensis</i>, e inativizuar me mungesë të mikroorganizmave të gjallë; - kur nuk disponohet nga prodhimi biologjik.
ex 12.1.12	Produktet e majave (Yeast products);	- produkt fermentimi i përftuar nga <i>Saccharomyces cerevisiae</i>, <i>Saccharomyces carlsbergensis</i>, i inaktivizuar me mungesë të mikroorganizmave të gjallë dhe që pëmban pjesë të majave; - kur nuk disponohet nga prodhimi biologjik.
	Kolesteroli (Cholesterol)	- produkt i përftuar nga dhjami/nyndyra e leshit (lanolina) nga saponifikimi, ndarja dhe kristalizimi, nga molusqet bivalvore ose burime të tjera për të siguruar nevojat sasiore dietike të karkalecave të familjes Penaeidae dhe karkalecave të ujërave të ëmbla (<i>Macrobrachium spp.</i>) në fazën e rritjes dhe në fazat e mëparshme të jetës. - kur nuk disponohet nga prodhimi biologjik.
	Bimë (Herbs)	- kur nuk janë të disponueshme në formë biologjike; - Prodhuar/përgatitur pa tretës kimike; - Maksimumi 1% në racionin e ushqimit për kafshë.
	Melasë (Molasses)	- kur nuk janë të disponueshme në formë biologjike; - Prodhuar/përgatitur pa tretës kimike; - Maksimumi 1% në racionin e ushqimit për kafshë.
	Fitoplanktoni dhe zooplanktoni (Phytoplankton and zooplankton)	- vetëm në rritjen e larvave të rasatit biologjik;
	Komponime proteinike të veçanta (specific protein compounds)	- kur nuk gjendet në formë biologjike; - prodhuar/përgatitur pa tretës kimikë;

		- për ushqyerjen e derrave deri në 35 kg ose shpendëve të vegjël; - maksimumi 5% të lëndës së thatë të ushqimit për kafshë me origjinë bujqësore për një periudhë 12-mujore
	Erëza (Spices)	- kur nuk janë të disponueshme në formë biologjike; - Prodhuar/përgatitur pa tretës kimike; - Maksimumi 1% në racionin e ushqimit për kafshë

PJESA B

ADITIVËT E USHQIMIT PËR KAFSHË DHE NDIHMËSIT E PËRPUNIMIT QË PËRDOREN NË USHQYERJEN E KAFSHËVE

Aditivët e ushqimit për kafshë të listuar në këtë pjesë duhet të përdoren në përputhje me kushtet e përcaktuara në kolonën e fundit të tabelës së mëposhtme.

1. ADITIVET TEKNOLOGJIK

A. Konservues

Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Kushtet dhe limitet e veçanta për përdorim
E 200	Acid sorbik (Sorbic acid)	
E 236	Acidformik (formic acid)	
E 237	Formatnatriumi HCOONa (Sodium formate)	
E 260	Acid acetik (Acetic acid)	
E 270	Acid laktik (lactic acid)	
E 280	Acid propionik (Propionic acid)	
E 330	Acid citrik (Citric acid)	

B. Antioksidant

Numrat ID ose grupet funksionale /	Substancat	Përshkrimi, kushtet dhe limitet për përdorim
1b306(i)	Tokoferol përftuar nga vajrat vegjetal (Tocopherol extracts from vegetable oils).	
1b306(ii)	Tokoferol - i pasuruar, përftuar nga vajrat bimor (Tocopherol-rich extracts from vegetable oils (delta rich)).	

C. Emulsifikues, stabilizues, trashës dhe agjentë xhelatinoz

Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Përshkrimi, kushtet dhe limitet për përdorim
E 322	Lecitin	Vetëm kur përftohet nga lëndë e parë biologjike. Përdoret vetëm për ushqyerjen e specieve të akuakulturës.

D. Agjent lidhës dhe jompiksës

Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Përshkrimi, kushtet për përdorim
E 412	Gomë guar (Guar gum)	
E 535	Ferrocianite natriumi (Sodium ferrocyanide);	Doza maksimale 20 mg/kg NaCl e llogaritur si anion ferrocianide.
E 551b	Silic koloidale (Colloidal silica).	
E 551c	Kieselgur (diatomaceous earth, purified).	
1m558i	Bentonite	
E 559	Argjila kaolinite, pa asbest (Kaolinitic clays, free of asbestos).	
E 560	Përzierje natyrale të steariteve dhe kloriteve; (Natural mixtures of steatites and chlorite).	
E 561	Vermikulite	
E 562	Sepiolite	

E 566	Natrolite-fonolite (Natrolite-Phonolite)	
1g568	Klinoptilolite me origjinë sedimentare. (Clinoptilolite of sedimentary origin).	
E 599	Perlite	

E Aditivë të silazhit

Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Përshkrimi, kushtet për përdorim
1k	Enzima dhe mikroorganizma; (Enzymes, micro-organisms).	Për të siguruar fermentim të përshtatshëm.
1k236	Formic acid (Formic acid).	
1k237	Formate natriumi; (Sodium formate);	
1k280	Acid propionik (Propionic acid)	
1k281	Propionat natriumi; (Sodium propionate)	

2. Aditivët shijues

Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Përshkrimi, kushtet për përdorim
ex2a	Astaxanthin	- vetëm kur përftohen nga burime biologjike, të tilla si guaskat e krustaceve biologjike; - vetëm në racionin ushqimor për salmonin dhe troftën brenda nevojave të tyre fiziologjike; - nëse nuk ka astaxanthin të përftuar nga burime biologjike, mund të përdoret astaxanthin nga burime natyrore, si p.sh., Astaxanthin-rich <i>Phaffia rhodozyma</i> ;
ex2b	Komponime aromatizuese (Flavouring compounds)	Vetëm ekstrakte nga produktet bujqësore, duke përfshirë ekstraktet e gështenjës (<i>Castanea sativa</i> Mill).

3. Aditivët ushqyes

a) Vitaminat, provitaminat dhe substancat kimikisht të mirë përcaktuara që kanë efekt të ngjashëm

Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Përshkrimi, kushtet për përdorim
3a	Vitamina dhe provitamina (Vitamins and Provitamins)	- E përftuar nga produktet bujqësore; Nëse nuk disponohet nga produktet bujqësore: - të përfthuara sintetikisht, vetëm ato që janë identike me vitaminat që përftohen nga produktet bujqësore mund të përdoren për kafshët monogastrike dhe kafshët e akuakulturës. - të përfthuara sintetikisht, vetëm vitaminat A, D dhe E që janë identike me ato që përftohen nga produktet bujqësore mund të përdoren për ripërtypësit; përdorimi të miratohet paraprakisht nga autoriteti kompetent bazuar në vlerësimin e mundësisë për ripërtypës biologjik për të përftuar sasi të nevojshme të këtyre vitaminave nëpërmjet racioneve të tyre ushqimor.
3a920	Anhidrit Betaine (Betaine anhydrous)	Vetëm për kafshët monogastrike nga prodhimi biologjik; në qoftë se nuk gjendet me origjinë natyrale.

b) Komponimet e elementeve gjurmë

Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Kushtet dhe kufijtë e veçantë
3b101	Karbonat hekuri (II) siderite; Iron(II) carbonate (siderite)	
3b103	Sulfat hekuri, monohidrat (Iron(II) sulphate monohydrate);	
3b104	Sulfat hekuri, heptahidrat (iron(II) sulphate heptahydrate);	
3b201	Joduri i kaliumit (Potassium iodide);	

3b202	Jodat kalciumi, anhidrit (Calcium iodate, anhydrous);	
3b203	Jodat kalciumi anhidrit i granular dhe i veshur (Coated granulated calcium iodate anhydrous);	
3b301	Tetrahidrat acetat kobalti (II) (Cobalt(II) acetate tetrahydrate);	
3b302	Karbonat kobalti (II) (Cobalt(II) carbonate);	
3b303	Hidroksid karbonat kobalti(II) (2:3) monohidrat (Cobalt(II) carbonate hydroxide (2:3) monohydrate);	
3b304	Karbonat kobalti (II) i granular dhe i veshur (Coated granulated cobalt(II) carbonate);	
3b305	Heptahidrat sulfat kobalti (II) (Cobalt(II) sulphate heptahydrate);	
3b 402	Monohidrat, dyhidroksi karbonat bakri (II), (Copper(II) carbonate dihydroxy monohydrate);	
3b 404	Oksid bakri, (Copper (II) oxide);	
3b 405	pentahidrat sulfat bakri, (Copper(II) sulphate pentahydrate);	
3b409	Trihidroksid klorur bakri II (Dicopper chloride trihydroxide (TBCC);	
3b502	Oksid mangani (Manganese (II) oxide);	
3b503	Monohidrat sulfat mangani, (Manganous sulfate, monohydrate)	
3b 603	Oksid zinku (Zinc oxide);	
	Heptahidrat Sulfat zinku (Zinc sulphate heptahydrate)	
3b 604	Monohidrat Sulfat zinku, (Zinc sulphate monohydrate)	
3b605	Monohidrat, Hidroksid klorur zinku	
3b609	(Zinc chloride hydroxide monohydrate (TBZC))	
3b701	Dyhidrat Molibdat natriumi (Sodium molybdate dihydrate);	
3b801	Selenite natriumi (Sodium selenite);	
3b802	Selenite natriumi të granuluara dhe veshuara (Coated granulated sodium selenite);	
3b803	Selenat natriumi (Sodium selenate);	
3b810	Maja e selenizuar, <i>Saccharomyces cerevisiae</i> , CNCM I-3060, e inaktivizuar;	
	(Selenised yeast, <i>Saccharomyces cerevisiae</i> CNCM I-3060, inactivated);	
3b811	Maja e selenizuar, <i>Saccharomyces cerevisiae</i> NCYC R397, e inaktivizuar;	
	(Selenised yeast, <i>Saccharomyces cerevisiae</i> NCYC R397, inactivated);	
3b812	Maja e selenizuar, <i>Saccharomyces cerevisiae</i> CNCM I-3399,e inaktivizuar;	
	(Selenised yeast, <i>Saccharomyces cerevisiae</i> CNCM I-3399, inactivated);	
3b813	Maja e selenizuar, <i>Saccharomyces cerevisiae</i> NCYC R646, e inaktivizuar;	
	(Selenised yeast, <i>Saccharomyces cerevisiae</i> NCYC R646, inactivated);	
3b817	Maja e selenizuar, <i>Saccharomyces cerevisiae</i> NCYC R645,e inaktivizuar;	
	(Selenised yeast, <i>Saccharomyces cerevisiae</i> NCYC R645 inactivated);	

c) Amino acidet, kripërat dhe analogët e tyre

Numri ose grupi funksional	Emri	Kushtet dhe limitet e veçanta
3c3.5.1 dhe 3c352	Monohidrat monohidroklorid L-histidine (L-histidine monohydrochloride monohydrate);	Prodhuar nga fermentimi, - mund të përdoret në racionin ushqimor të salmonit, kur burimet ushqimore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për burimet e ushqimit për kafshët e akuakulturës biologjike, nuk ofrojnë një sasi të mjaftueshme histidine për të plotësuar nevojat dietike të peshkut.

4. ADITIVET ZOOTEKNIK

Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Kushtet dhe kufijtë e veçanta
4a, 4b, 4c dhe 4d	Enzima dhe mikroorganizma (Enzymes and microorganism);	

PRODUKTET PËR PASTRIM DHE DIZINFEKTIM

1. Produktet për pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve dhe pajisjeve në prodhimin biologjik blegtoral:

- sapun kaliumi dhe natriumi (Potassium and sodium soap);
- ujë dhe avull (water and steam);
- qumësht gëlqere (Milk of lime);
- gëlqere (Lime);
- gëlqere e pashuar (Quicklime);
- hipoklorit natriumi (p.sh. si zbardhues i lëngshëm) Sodium hypochlorite (e.g. as liquid bleach);
- peroksid hidrogjeni (Hydrogen peroxide);
- esenca natyrale të vajit të farave të linit, dhe vaj mente (linseed oil, lavender oil and peppermint oil);
- acidi citrik, peracetik, formik, laktik, dhe acetik (Citric, peracetic acid, formic, lactic, and acetic acid);

- alkool (Alcohol);
- formaldehide (Formaldehyde);
- produktet për pastrimin dhe dezinfektimin e thithave dhe pajisjeve për mjelje;

2. Produktet që përdoren për pastrim dhe dezinfektim në prodhimin e specieve të akuakulturës dhe prodhimin e algave të detit.

2.1 Produktet që përdoren për pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve dhe pajisjeve kur nuk janë të pranishme në kultivim speciet e akuakulturës, të përmbajnë substancat aktive si më poshtë:

- Ozon (ozone);
- Hipoklorit natriumi (sodium hypochlorite);
- Hipoklorit kalciumi (calcium hypochlorite);
- Hidroksid kalciumi (calcium hydroxide);
- Oksid kalciumi (calcium oxide);
- Alkool (alcohol);
- Përzierje e peroksomonosulfatit të kaliumit dhe klorur natriumi që prodhojnë acid hipoklorik (mixtures of potassium peroxomonosulphate and sodium chloride producing hypochlorous acid);

2.2 Produktet që përdoren për pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve dhe pajisjeve kur janë ose jo të pranishme në kultivim speciet e akuakulturës, të përmbajnë substancat aktive si më poshtë:

- Gur gëlqeror (karbonat kalciumi) për kontrollin e pH (limestone (calcium carbonate) for pH control);
- Dolomite për korrigjimin e pH (përdoret vetëm në prodhimin e karkalecave); (dolomite for pH correction (use restricted to shrimp production);
- Klorur natriumi (sodium chloride);
- Peroksid hidrogjeni (hydrogen peroxide);
- Perkarbonate natriumi (sodium percarbonate);
- Acide biologjike (acid acetik, acid laktik, acid citrik); (organic acids (acetic acid, lactic acid, citric acid);
- acidet peracetike (peracetic acids);
- jodofore (vetëm kur janë në fazën e vezëve); (iodophores (only in the presence of eggs).